



Atë që e dëmton muslimanin, Allahu do ta dëmtojë, dhe atij që ia vështirëson muslimanin, Allahu do t'ia vështirësojë

Ebu Sirme (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atë që e dëmton muslimanin, Allahu do ta dëmtojë, dhe atij që ia vështirëson muslimanin, Allahu do t'ia vështirësojë."

[رواه أبو داود والترمذي وابن ماجه وأحمد] [Hadith hasen]

Profeti ﷺ në këtë hadith tërhoqi vërejtjen nga lëndimi e futja e dëmit dhe vështirësisë te një musliman, qoftë në veten e tij, qoftë në pasurinë a familjen e tij. Kushdo që i fut dëm dhe vështirësi një muslimani, Allahu do ta dënojë atë në të njëjtën mënyrë si puna e tij.

<https://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/5375>

